



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:014754
Datë: 26.02.2020
Numri i dokumentit: 00858828
P.nr.99/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit E.J nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokatja Jehona Sylejmani nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr. 170/2020, të datës 11.02.2020, pas mbajtjes së seancës dëgjimore lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, mori dhe publikisht me datën 18.02.2020, shpalli ndërsa me datë 26.02.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E.J, nga babai A... dhe nëna N., e lindur H., i lindur me datë .., në Gjilan, ku dhe jeton rruga: “...” nr. ..., ka të kryer shkollën e mesme, i divorcuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 31.01.2020, rreth orës 11:40 minuta, në rrugën “Ali Huruglica” në Gjilan, i pandehuri E.J, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për tjetrin, me dashje ka kryer vjedhje në dëm të vëllaut të tij tani të dëmtuarit E.J..1, ashtu që i njëjti me çelës e hap derën e dhomës së fjetjes dhe nga dollapi merr stoli ari edhe atë një palë vathë, dy unaza si dhe byzylyk dore dhe të njëjtat i shet nëpër argjendar të ndryshëm, kështu që i pandehuri me veprimet e tij, të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 1000 euro.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 233, 247 dhe 365 të KPP-ës, të pandehurit E.Ji shqipton:

DËNIM ME BURGIM I CILI DËNIM ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT ZËVENDËSOHET NË DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit E.J për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 500 €(pesëqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, i cili dënim në bazë të nenit 44 të KPRK-ës dhe me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 300 €(treqind euro).

Meqenëse të pandehurit i janë shqiptuar dy dënime me gjobë dhe atë në shumë prej 500 € (pesëqind euro) dhe 300 € (treqind euro), gjykata të njëjtit i shqipton dënim me gjobë në shumë të përgjithshme prej 800 €(tetëqind euro), të cilën i pandehuri obligohet ta paguajë në 3 (tri) këste të barabarta, brenda afatit prej 3 (tre) muajve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehurit nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 €(njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 79 të KPRK-ës, të pandehurit E.J, koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 02.02.2020 deri me datë 18.02.2020, do ti llogaritet në dënimin e zëvendësuar me gjobë.

I dëmtuari E.J..1 për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €(njëzet euro) ndërsa në emër të ligjit për kompensimin e viktimave shumë prej 30 €(tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 11.02.2020, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.170/2020, kundër të pandehurit E.J nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, së bashku me aktakuzë prokuroria ka dorëzuar edhe Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë me numër PP.II.nr.170/2019, të datës 11.02.2020, të arritur mes Prokurorisë Themelore në Gjilan në njërën anë dhe të pandehurit E.Jme mbrojtësen e tij avokaten Jehona Sylejmani në anën tjetër sipas të cilës marrëveshje kësaj gjykate i është rekomanduar që të pandehurin për shkak të veprës penale e cila i vihet në barrë, ta shpallë fajtorë dhe të njëjtit ti shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe

komfor nenit 44 të KPRK-së të i mundësohet që dënimi me burg të i zëvendësohet me dënim me gjobë në shume prej 500 (pesëqind) euro.

2.Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Me datë 18.02.2020, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e dëgjimore në lidhje me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në të cilin ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri E.J me mbrojtësen e tij sipas detyrës zyrtare avokaten Jehona Sylejmani nga Gjilani, ku pas dëgjimit të palëve gjykata në bazë të nenit 233 paragrafi 21 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë me numër PP.II.nr.170/2020, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 233 paragrafi 18 të KPP-ës. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë e arritur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të pandehurit E.J me mbrojtësen e tij avokaten Jehona Sylejmani, i përmbush të gjitha kushtet ligjore si dhe e njëjta është arritur në bazë të nenit 233 të KPP-ës, po ashtu gjykata ka konstatuar faktin se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë vullnetarisht pas konsultime të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe prova materiale e rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara nga neni 253 paragrafi 1 e 2 të KPP-ës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri E.J ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 i KPRK-ës, në kohën, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit E.J , duhet ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit të i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) Euro, ngase sipas vlerësimit të gjykatës ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69, 70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në një fazë të hershme të procedurës penale, se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën e cila iu vihet në barrë, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga deklaratat mbi pranimin e fajësisë e cila i është bashkangjitur marrëveshjes së lartcekur dhe se këtë pranim të fajësisë i pandehuri e ka bërë në mënyrë vullnetare pa qenë i shtyer nga askush dhe atë pas njoftimeve lidhur me pasoja dhe benefitet e arritjes së marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, faktin se i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija duke kërkuar falje për këto veprime si dhe njëkohësisht ka premtuar që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla e as vepra të tjera penale, po ashtu gjykata mori parasysh edhe rrethanat personale dhe karakteristikat e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njëjti bie ndesh me ligjin përkatësisht i njëjti më parë i njëjti nuk ka qenë i gjykuar as dënuar më parë me ndonjë aktgjykim të formës së

prerë ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori dashjen e të pandehurit për të kryer veprën penale ku nga shkresat e lëndës shihet se i njëjti me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka kryer vjedhje në dëm të vëllaut të tij me ç'rast i ka marrë stoli ari, të cilat më pastaj i ka shitur nëpër argjendari, andaj gjykata konsideron se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5.Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Duke pasur parasysh se i pandehuri E.J me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, PPr.nr.19/2020, të datës 02.02.2020, i është caktuar masa e paraburgimit, andaj gjykata në kuptim të nenit 79 të KPRK-ës, kohën e kaluar nën masën e paraburgimit dhe atë nga data 02.02.2020 deri me datë 18.02.2020, do t'ia llogaritet në dënimin e zëvendësuar me gjobë.

6. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarin E.J..1, e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €(njëzet euro) ndërsa në emër të ligjit për kompensimin e viktimave shumë prej 30 €(tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.99/2020, me datë 26.02.2020

Zyrtarja Ligjore
Eronita Llapashtica
Sermaxhaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind

KËSHILLA JURIDIKE: Meqenëse prokurori i shteti, i pandehuri si dhe mbrojtësja e tij në seancën dëgjimore lidhur me pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës atëherë ky aktgjykim në bazë të nenit 485 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, merr formën e prerë dhe bëhet i ekzekutueshëm sot me datë 26.02.2020.